



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of
Internal Affairs
INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE
INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU
KOSOVO INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION



		REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME / MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE / INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU / KOSOVO INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION	
Nr. Org. Br. List. Org. Unit	45801	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	458
Nr. Fajere Br. Strana No. Pages	- 12 -	Data Datum Date	26 / 12 / 25

Plani i Performancës për vitin 2026

Dhjetor, 2025

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	3
2. Hyrja	3
3. Konteksti.....	4
4. Metodologjia	5
5. Përmbledhja e objektivave	5
6. Zbatimi i Planit të Performances së Institutit të Kosovës për Administratë Publike	5
7. Monitorimi dhe raportimi	6
8. Ndikimi buxhetor	6
9. Sfidat dhe rreziqet.....	7

1. Përmbledhje Ekzekutive

Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), me përgjegjësi për trajnimin dhe zhvillimin profesional të nëpunësve civilë. Në zbatim të misionit të tij, në Planin e Punës për vitin 2026, IKAP ka përcaktuar pesë (5) objektiva kryesore të punës, si dhe Planin dinamik për zbatimin e tyre, si vijon:

1. Ngritja e kapaciteteve të nëpunësve civilë;
2. Digjitalizimi i shërbimeve për zhvillimin e trajnimeve përmes platformës digjitale;
3. Bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat partnere;
4. Plotësimi i Kornizës Ligjore përmes hartimit dhe miratimit të legjislacionit dytësor;
5. Plotësimi i vendeve të lira të punës dhe funksionalizimi i plotë i strukturës së re organizative.

IKAP ka gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) pozita pune, të sistemuara në tri (3) njësi organizative dhe katër (4) divizione, si në vijim:

- Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm;
- Departamenti për Planifikim dhe Vlerësim të Trajnimeve;
- Divizioni për Vlerësimin e Nevojave për Trajnim dhe Hartimin e Kurrikulave;
- Divizioni për Menaxhimin e Cilësisë së Trajnimeve;
- Departamenti për Organizimin e Trajnimeve;
- Divizioni për Organizim të Trajnimeve për Nivelin Qendror;
- Divizioni për Organizim të Trajnimeve për Nivelin Lokal.

Buxheti i IKAP-it për vitin 2026 është **354,930.00 euro**. Për zbatimin e plotë të Planit të Punës, IKAP ka kërkuar një buxhet shtesë prej 50,000.00 euro, i cili është aprovuar dhe alokuar në kategorinë Mallra dhe Shërbime.

Kapacitetet teknike për zbatimin e Planit të Punës përfshijnë objektin e përshtatshëm për zhvillimin e trajnimeve, si në aspektin teorik ashtu edhe praktik, sallat e pajisura me kompjuterë, Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Trajnimeve (SEIKAP), Sistemin e Përzgjedhjes së Trajnerëve (SPT), ueb-faqen zyrtare për promovimin e aktiviteteve dhe komunikimin me palët e interesuara, si dhe rrjetin social Facebook.

2. Hyrja

a) Fushëveprimi

Plani i Performancës për vitin 2026 është dokumenti vjetor kryesor përmes të cilit mbështetet zhvillimi profesional dhe aftësimi i nëpunësve civilë, si dhe forcimi i kapaciteteve të brendshme të Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP). Instituti i Kosovës për Administratë Publike (në tekstin e mëtejme: IKAP) është institucion publik i themeluar fillimisht me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/25, në vitin 2003, ndërsa më pas funksionimi i tij është rregulluar me Ligjin Nr. 041 – 221 për Institutin e Kosovës për Administratë Publike, i miratuar më 28 prill 2014.

IKAP, është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, aftësimin profesional dhe zhvillimit të kapaciteteve në Shërbimin Civil, për të gjitha institucionet e Shërbimit Civil në nivel qendror dhe lokal. Gjithashtu, IKAP ka kompetencë të ofrojë trajnime për persona fizikë dhe juridikë, me qëllim krijimin dhe avancimin e një sektori publik profesional, efikas dhe efektiv, i cili ofron shërbime publike në kohë dhe me cilësi të lartë, në përputhje me standardet më të mira të pranuar ndërkombëtarisht.

Funksionet kyçe përmes të cilave zbatohet veprimtaria e IKAP-it përfshijnë:

- Këshillon dhe mbështet Ministrinë gjatë përgatitjes së strategjive për aftësimin e nëpunësve civilë dhe zbaton këto strategji pas miratimit të tyre;
- Identifikon dhe vlerëson, në mënyrë periodike, nevojat për aftësimin e nëpunësve civilë në Republikën e Kosovës, në nivel qendror dhe lokal;
- Grumbullon planet e trajnimit pas vlerësimit vjetor të performancës dhe i integron ato në Planin Vjetor të Trajnimit, deri më 30 maj të çdo viti;
- Harton programe të përshtatshme të aftësimin që përmbushin nevojat e identifikuara dhe vlerëson rezultatet e programeve të aftësimin të organizuara për këtë qëllim;
- Ofron trajnime për aftësimin dhe zhvillimin profesional të nëpunësve civilë në nivel qendror dhe lokal;
- Harton planin afatmesëm dhe afatgjatë të IKAP-it;
- Koordinon aktivitetet me institucionet në nivel qendror e lokal, si dhe aktivitetet e donatorëve në fushën e aftësimin në Shërbimin Civil;
- Kryen hulumtime, organizon forume dhe diskutime për nevojat për trajnim dhe zhvillimin profesional të nëpunësve civilë.

b) Vizioni – Vizioni i IKAP-it është të kontribuojë në krijimin e një administrate publike moderne, profesionale dhe funksionale, në shërbim të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

c) Misioni – Instituti i Kosovës për Administratë Publike është institucioni kryesor për aftësimin dhe zhvillimin profesional të nëpunësve civilë. IKAP-i punon për forcimin e kapaciteteve të nëpunësve civilë dhe të administratës publike në përgjithësi, në fushat menaxheriale dhe funksionale.

d) Vlerat – IKAP, në veprimtarinë e tij, mbështetet në parimet e ligjshmërisë, menaxhimit cilësor, ligjshmërisë, efikasitetit, profesionalizmit dhe paanësisë.

3. Konteksti

Plani i Performancës për vitin 2026 i IKAP-it, është hartuar në përputhje me prioritetet dhe synimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuara në Programin e Qeverisë, Strategjinë e Reformës së Administratës Publike (SRAP) 2022-2027 dhe Planin e Veprimit 2025-2027, Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2030, Raportin për Vlerësimin e Nevojave për Trajnim për vitin 2025, Kurrikulat e Trajnimit për nivelin qendror dhe lokal për vitin 2026, si dhe dokumente të tjera strategjike dhe ligjore që rregullojnë sektorë të veçantë.

Realizmi i vizionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës do të kontribuojë në përmirësimin e mirëqenies ekonomike dhe sociale të qytetarëve të vendit dhe, në aspektin e jashtëm, do të mundësojë integrimin e Kosovës në organizatat rajonale dhe globale.

Arritja e synimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës është e mundur përmes burimeve njerëzore profesionale. Me qëllim të avancimit profesional të nëpunësve civilë, IKAP ka hartuar këto dokumente në vijim të trajnimit për zhvillimin e shërbimit civil:

- Vlerësimi i Nevojave për Trajnim për periudhën 2026-2028;
- Kurrikula e Trajnimit për Nivelin Qendror për vitin 2026;
- Kurrikula e Trajnimit për Nivelin Lokal për vitin 2026;
- Programi i Trajnimit për Prokurim Publik – Programi Themelor për vitin 2026;
- Programi i Trajnimit për Prokurim Publik – Programi i Avancuar për vitin 2026.

Edhe gjatë vitit 2026, një pjesë e trajnimeve do të organizohen në bazë të kërkesave specifike që parashtrihen nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal.

4. Metodologjia

Plani i Performancës i IKAP-it për vitin 2026 është hartuar në dy faza:

Faza e parë: Gjatë kësaj faze është bërë analiza e dokumenteve relevante përfshirë strategjitë, ligjet, raportet, projektet e bashkëpunimit dhe dokumentet tjera përkatëse. Kjo analizë ka shërbyer për identifikimin e objektivave dhe harmonizimin e tyre me objektivat e Ministrisë dhe të Qeverisë.

Faza e dytë: Gjatë fazës së dytë, bazuar në të dhënat e grumbulluara, janë përcaktuar objektivat, sfidat dhe plani dinamik i zbatimit.

Plani i Performancës është hartuar dhe dakorduar në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse-Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

5. Përmbledhja e objektivave

Qëllimi dhe objektivat e Planit të Performancës janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me prioritetet, nevojat dhe sfidat e identifikuara. Qëllimi i përgjithshëm i Planit të Performancës është zhvillimi dhe profesionalizimi i nëpunësve civilë, me qëllim mbështetjen e zbatimit të prioritetëve dhe reformave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët dhe bizneset.

Të gjitha prioritetet dhe nevojat e identifikuara janë përfshirë në pesë (5) objektiva vjetore, të cilat synojnë arritjen e qëllimit të përgjithshëm, zbatimin e prioritetëve të Qeverisë së Kosovës dhe përmbushjen e nevojave të identifikuara për zhvillim të kapaciteteve.

6. Zbatimi i Planit të Performances së Institutit të Kosovës për Administratë Publike

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e Planit të Performancës janë:

- Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm;
- Departamenti për Planifikim dhe Vlerësim të Trajnimit;
- Divizioni për Vlerësimin e Nevojave për Trajnim dhe Hartimin e Kurrikulave;
- Divizioni për Menaxhimin e Cilësisë së Trajnimeve;

- Departamenti për Organizimin e Trajnimeve;
- Divizioni për Organizimin e Trajnimeve për Nivelin Qendror;
- Divizioni për Organizimin e Trajnimeve për Nivelin Lokal.

7. Monitorimi dhe raportimi

Struktura për monitorimin e zbatimit të Planit të Performancës përbëhet nga indikatorë matës sasiore dhe cilësor, të vendosur në nivel të objektivave. IKAP-i ka përcaktuar procedura të detajuara për zbatimin, monitorimin dhe raportimin, të cilat realizohen në baza mujore, periodike, vjetore dhe sipas nevojave specifike.

Procesi i monitorimit bëhet në dy nivele:

1. Sistemi i brendshëm i monitorimit, i realizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i agjencisë;
1. Monitorimi i performancës nga njësi përgjegjëse - Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (DMZP).

8. Ndikimi buxhetor

Zbatimi i Planit të Performancës do të realizohet me fondet e Buxhetit të Kosovës, si dhe me mbështetjen e donatorëve. Buxheti i ndarë për IKAP për vitin 2026 është i njëjtë me atë të vitit të kaluar. Buxheti i ndarë për IKAP për vitin 2026 arrin vlerën 354,930.00euro.¹

Tabela në vijim jep një përmbledhje të buxhetit, të ndarë sipas kategorive të përcaktuara në Qarkoren Buxhetore.

Tabela . Buxheti sipas kategorive për vitin 2026

Nr.	Kategoria ekonomike	Buxheti për IKAP sipas KASH
1	Paga dhe shtesa	149,716.00 €
2	Mallra dhe shërbime	198,714.00 €
3	Komunali	6,500.00 €
∑	TOTALI	354,930.00 €

¹ Për më shumë, shihe Kornizën Afatmesëm të Shpenzimeve 2026-2028

9. Sfidat dhe rreziqet

Gjatë realizimit të Planit të Performancës, IKAP-i mund të përballlet me sfida dhe rreziqe të ndryshme, përfshirë:

- Mungesën e buxhetit të mjaftueshëm;
- Pamundësinë për angazhimin e trajnerëve/ekspertëve nga jashtë procedurave të UA;
- Mungesën e kapaciteteve profesionale dhe të burimeve njerëzore për ofrimin e trajnimeve digjitale;
- Nevojën për përditësimin e materialeve të trajnimit;
- Krijimin e sistemeve elektronike për testim;
- Mungesën e shërbimeve mbështetëse.

Plani i Veprimit për Zbatimin e Planit të Performancës

Data:		22.12.2025						
Agjencia		Instituti i Kosovës për Administratë Publike						
Ministria përgjegjëse		Ministria e Punëve të Brendshme						
Misioni i agjencisë		Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) është institucioni kryesor për aftësimin e nëpunësve civilë. IKAP-i punon për zhvillimin e kapaciteteve të nëpunësve civilë dhe të administratës publike në përgjithësi, duke përfshirë fushat menaxheriale dhe funksionale.						
Objektivat e punës për vitin 2026	Treguesi(t)	Aktivitetet	Vlera bazë	Vlera e synuar	Rezultatet	Alokimi financiar	Afat i kohës	Referenca në dokumente strategjike/politike
1. Ngritja e kapaciteteve të nëpunësve civilë.	- Numri i trajnimeve të organizuara.	Organizimi i trajnimeve sipas planit vjetor të trajnimit.	3700	5500 nëpunës të trajnuar.	5500 nëpunës civilë kanë ngritur kapacitetet.	170,000.00 euro.	K1 – K4	Plani i trajnimit; Kurikulat e trajnimit.
	- % e kërkesave të realizuara.	Organizimi i trajnimeve sipas kërkesave specifike nga institucionet	30 kërkesa.	40 kërkesa.	Nëpunësit e trajnuar sipas kërkesave.	5,000.00 euro.	K1- K4	Kërkesat e drejtuara në IKAP.
	- Numri i kurseve të vendosura në moodle.	Rishikimi i Vlerësimit të nevojave të trajnimit (VNT)	VNT e miratuar.	Raporti i Rishikimit të VNT i miratuar.	Vlerësimi i nevojave të trajnimit i rishikuar.	1,000.00 euro.	K1- K4	Plani i trajnimit; Kurikulat e trajnimit.
	- Numri i procedurave të hartuara dhe miratuara.	Përditësimi i procedurave të menaxhimit të ciklit të trajnimit.	0	3 proceduara të përditësuara.	Procedurat e menaxhimit të ciklit të trajnimit janë përditësuar.	Kosto administrative.	K1	Ligji i IKAP-it.

Plani i Performancës për vitin 2026

<p>2. Digitalizimi i shërbimeve për zhvillimin e trajnimeve përmes platformës digjitale.</p>	<p>- Numri i trajnimeve të organizuara përmes platformës. - Numri i udhëzuesve të hartuar. - Numri i zyrtarëve të trajnuar përmes platformës.</p>	<p>Zhvillimi i kurseve dhe trajnimeve përmes platformës. Funksionalizimi dhe përdorimi i Platformës moodle për trajnime. Hartimi i udhëzuesve për përdorimin e platformës.</p>	<p>2 kurse. Është pilotuar platforma moodle. 1</p>	<p>5 kurse. Platforma e funksionalizuar. 2 Udhëzuesi i hartuar.</p>	<p>Kurset e trajnimit përmes platformës të zhvilluara. Platforma moodle në funksion. Udhëzuesit e aprovuar dhe zbatimi i tyre.</p>	<p>1,000.00 euro. Donatorë. Kosto administrative.</p>	<p>K2 K1 K1</p>	<p>Plani i trajnimit; Memorandumet e mirëkuptimit në mes IKAP-it dhe partnerëve. Marrëveshje me LUX Dev. Ligji i IKAP-it; UA për trajnerë.</p>
	<p>Trajnimi i nëpunësve civil me programet e caktuara përmes platformës. Hartimi i planit të trajnimeve në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat partnere.</p>	<p>2 kurse. Plani i trajnimeve për vitin 2025.</p>	<p>5 kurse. Miratimi i planit për trajnime me institucionet partnere.</p>	<p>160 nëpunës të trajnuar përmes platformës moodle. Financimi nga institucionet partnere bëhet sipas planit të dakorduar.</p>	<p>1,000.00 euro Donatorë. Kosto administrative.</p>	<p>K1-K4 K1</p>	<p>Memorandumet e mirëkuptimit në mes IKAP-it dhe partnerëve.</p>	

Plani i Performancës për vitin 2026

3. Fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat partnere.	- Numri i ngjarjeve të përbashkëta me organizatat. - Numri i marrëveshjeve të nënshkuara. - Numri i vizitave studimore të realizuara.	Zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta me institucionet partnere. Organizimi i takimeve të rregullta me organizatat me të cilat IKAP ka nënshkuar marrëveshje. Organizimi i tryezave dhe punëtorive të përbashkëta me organizatat partnere.	5 trajnime	10 trajnime	200 nëpunës të trajnuar.	5,000.00 euro (donatorët).	K1-K4	MIM me partnerë dhe IKAP.
		Organizimi i takimeve të rregullta me organizatat me të cilat IKAP ka nënshkuar marrëveshje.	2 takime	Takime periodike (tremujore).	Marrëveshjet e nënshkuara nga IKAP, zbatohen në praktikë.	Kosto administrative.	K1-K4	MIM me partnerë dhe IKAP.
		Organizimi i tryezave dhe punëtorive të përbashkëta me organizatat partnere.	3 punëtori të organizuara.	4 punëtori të organizuara.	Bashkëpunimi me organizata është rritur.	3,000.00 euro.	K1-K4	Ligji i IKAP-it.
		Realizimi i vizitave studimore me institutet dhe shkollat për administratë publike.	3 vizita studimore.	4 vizita studimore.	Ngrita e kapaciteteve për stafin e brendshëm të IKAP.	5,000.00 euro (Donatorët).	K1-K4	MIM me partnerë dhe IKAP.
4. Përmirësimi i procesit të	- Numri i trajnerëve të ri-certifikuar	Miratimi i Projekt-Udhëzimit Administrativ për kushtet e angazhimit, kategorizimit dhe pagesës	Drafti fillestar është i Projekt-Udhëzimit Administrativ është hartuar.	Miratimi i Udhëzimit Administrativ.	Lehtësimi i procedurës për angazhim të trajnerëve.	Kosto administrative.	K3	Plani i Akteve Nënligjore i MPB-së.

Plani i Performancës për vitin 2026

angazhimit të ekspertëve.	- numri i materialeve të trajnimit të rishikuara.	së trajnerëve në IKAP. Ri-certifikimi i trajnerëve sipas procedurave të UA të ri.	0	50 trajnerë të ri-certifikuar.	Përmirësimi i cilësisë së trajnimeve.	10,000.00 euro (Donatorët).	K1-K4	Ligji i IKAP; UA për trajnerë.
	Rishikimi i materialeve të trajnimit.	Rishikimi i materialeve të trajnimit.	0	30 % e materialeve të trajnimit të rishikuara.	Përmirësimi i cilësisë së materialeve të trajnimit.	Kosto administrative.	K1-K3	Plani i Akteve Nënligjore i MPB-së.
	Zhvillimi i analizës për përmirësimin e metodologjisë së përzgjedhjes së trajnerëve.	Trajnerët përzgjedhen manualisht.	0	Krijimi i metodologjisë për përzgjedhjen dhe angazhimin e trajnerëve mbi baza meritore.	Përmirësimi i procesit të përzgjedhjes së trajnerëve.	Kosto administrative.	K1	
	Plotësimi i pozitave të lira në IKAP.	2 pozita të lira.	0	Të gjitha pozitat e lira në IKAP të plotësuara.	Kompletimi i strukturës organizative.	Kosto administrative.	K1-K4	Ligji i LZP; Rregullore për Procedurën e Pranimit në SHC; Rregulloreja e Brendshme e IKAP-it.
	- Numri i pozitave të lira të plotësuara. - Numri i trajnimeve për stafin e	Përgatitja e planit të trajnimeve për aftësimin e stafit.	0	Organizimi i tre trajnimeve për stafin e IKAP-it.	Stafi i trajnuar me trajnime të specializuara	IKAP/Donatorë.	K1-K2	Ligji i IKAP-it; LZP; Rregulloreja e Brendshme e IKAP-it.

Plani i Performancës për vitin 2026

<p>5. Avancimi i kapaciteteve të IKAP-it për realizimin e mandatit të tij.</p>	<p>brendshëm të realizuara. - Numri i tabelave të mençura, tavolinave dhe karrigeve të blera.</p>	<p>Pajisja e sallave me mjete për zhvillimin e trajnimit interaktiv.</p>	<p>0</p>	<p>10 tabela të mençura; 60 tavolina pune; 60 karrige; 6 monitorë.</p>	<p>Puna do të jetë më efektive dhe do të ketë menaxhim efikas të kohës.</p>	<p>56,000.00 buxhet të ministrisë.</p>	<p>K1- K4</p>	<p>Plani i Prokurimit i MPB-së.</p>
<p>- Numri i aktiviteteve të përbashkëta me DMZP-në.</p>	<p>Bashkëpunim i dhe koordinimi me DMZP-në.</p>	<p>Pjesëmarrja në takime të përbashkëta.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të trajnimit të zyrtarëve, i përmirësuar.</p>	<p>Kosto administrative.</p>	<p>K1- K4</p>	<p>K1- K4</p>	<p>K1- K4</p>	
<p>- Numri i aktiviteteve të përbashkëta me DMZP-në.</p>	<p>Avancimi i SEIKAP.</p>	<p>Sistemi nuk është i përditësuar.</p>	<p>Sistemi SEIKAP është funksional.</p>	<p>5.000 euro (donatorët).</p>	<p>K1</p>	<p>K1</p>	<p>K1</p>	
<p>- Numri i aktiviteteve të përbashkëta me DMZP-në.</p>	<p>Funksionalizimi i ndërlidhjes mes SEIKAP dhe SIMBNJ-së.</p>	<p>Sistemet janë të ndërlidhura, por nuk janë funksionale.</p>	<p>SEIKAP dhe SIMBNJ janë të ndërlidhura dhe funksionojnë.</p>	<p>Kosto administrative.</p>	<p>K2</p>	<p>K2</p>	<p>K2</p>	

Hysen Muzliukaj



Drejtor i Përgjithshëm

Qëndrim Bytyqi



Drejtor i Departamentit

Instituti i Kosovës për Administratë Publike

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë